

# Arsimimi

## KULTURA E NJERIUT



*L-Ex- busietin*

Nëntor, 2020

Delegacioni i SBASHK-ut u takua me Ministrin Likaj  
**U debatua për aktualitetin në arsim dhe kërkesat e SBASHK-ut**



Në fillim të muajit nëntor kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me ministrin Ramë Likaj dhe shefin e kabinetit të tij Gëzim Berisha. Në këtë takim të radhës është debatuar për aktualitetin në arsim dhe përkushtimet e anëtarësisë së SBASHK-ut. U vlerësua lart angazhimi i përbashkët për rrjedhën e mbarë të procesit mësimor dhe realizmit të ... (faqe 6)

Pjesëmarrje aktive në takimet për situatën në arsim

**SBASHK** me shembuj konkretet të përkushtimit të punëtorëve arsimor

GIZ në bashkëpunim me MASH-in, SBASHK-un dhe partnerë të tjera ka nisur tani e sa kohë fushatën e... (faqe 9)

Intervistë me Skënder Gashin, kryetar i nivelit komunal sindikal në Malishevë

Shërbimi ndaj atdheut me pendë e me pushkë



Numri për nëntorin i gazetës sonë ka ... (faqe 3)

Konferenca zgjedhore e Sindikatave të Arsimit të Evropës

**Kryetarja Blover në raportin e saj vend meritor i dha arsimit në Kosovë**



Ishte planifikuar që Konferenca zgjedhore ... (faqe 8)

Edhe fundi i tetorit dhe fillimi i nëntorit shënojnë vazhdimin e trajnimeve

**Stafi qendror në krye të detyrës duke respektuar vullnetin e anëtarësisë**



Gjatë gjithë këtij viti SBASHK ka shënuar... (faqe 6)

## Editorial

### Nëntori i datave dhe ngjarjeve të mëdha



I veçantë është muaji nëntor. Ai e bën njeriun të shpalos kujtimet dhe të kthehet në data për të lartësuar kujtimin për njerëzit e kombit, që shkuan faqe të ndritura të historisë sonë kombëtare. Nëntori na kthen kujtimin te Vlora e historisë dhe na duket se po dëgjojmë zërin e vendosur të trimave të kohës. Na duket se po shohim prapë Isa Boletinin dhe trimat tjerë nga Kosova teksa puthin flamurin dhe betohen para tij se do të vazhdojnë luftën përlirinë e atdheut.

Nëntori shpalos kujtimet dhe lartëson kujtimin për Komandantin legjendar Adem Jashari dhe për gjithë trimat e heronjtë e kombit tonë që në beteja heroike e ngritën lart emrin e Kosovës

dhe i sollën lirinë këtij trualli të larë me gjak nëpër vite e dekada.

Nëntori i krenarisë sonë lartëson kujtimin edhe përmësuesit shqiptarë që nëpër shekuj e dekada mbajtën gjallë këngën dhe fjalën e bukur shqipe.

Nëntori bart nga Vlora në Tiranë, nga Tirana në Prishtinë e kudo tjetër mesazhin për unitet dhe angazhim e përkushtim të përbashkët. Kombi e atdheu edhe tani e gjithmonë ka nevojë për angazhime e punë të mbara për të. Të tregohemi me vepra se e duam atdheun . Të tregohemi me vepra se jemi krenar për datat dhe ngjarjet e mëdha të nëntorit nëpër shekuj e dekada. Ne të vazhdojmë me misionin tonë të shenjtë në edukimin e arsimimin e brezave. Këtë ia kemi borxh Kosovë dhe kujtimit për gjithë emrat e mëdhenj të historisë sonë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të viziton ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos heziton të na jepni sygjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektonike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë,së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rrëth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)**

përfaqëson rrëth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë,duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit International (EI) që nga viti 1996.**

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +383 (0)38/ 226 940



## Intervista

### Intervistë me Skënder Gashin, kryetar i nivelit komunal sindikal në Malishevë

Shërbimi ndaj atdheut me pendë e me pushkë



*Numri për nënitorin i gazetës sonë ka elemente festive e të kujtesës sonë krenare. Në këtë numër biseduam me një mësimdhënës, veprimtar e luftëtar të lirisë. Ai është edhe sindikalist i dalluar. Skënderi kujton se shërbimi ndaj atdheut, ashtu si e kërkon koha, bëhet me pendë, por edhe me pushkë.*

#### Arsimimi sot

Kush është Skënder Gashi?

#### Skënderi:

Jam Skënder Gashi i lindur më 05.10.1960 në Vërmicë të Malishevës. 8-vjeçaren e kam kryer në ShFMU “Mustafa Bakija” tashmë “Hilmi Hoti” në Carrallukë, ndërsa shkollimin e mesëm në gjimnazin “Luigj Gurakuqi” në Kijevë. Studimet themelore i kam vazhduar në ShLP “Bajram Curri” në Gjakovë, në vitin 1981, në drejtimin emësimitklasor.

Punën me ditar e fillova në vitin 1984 dhe e vazhdoj deri më sot, ku këtë veprimtari e kryej me përgjegjësi dhe profesionalizëm duke u angazhuar në të gjitha kërkesat e arsimit të atëhershëm dhe të sotëm.

Gjatë kohës së luftës, iu bashkëngjita Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndjenjë kjo, e cila më dha frysëzim edhe më shumë se si duhet dashur e mbrojtur atdheun; qoftë me pendë e qoftë me pushkë. Në vitin 2012, në kuadër të Fakultetit të Edukimit, në Prizren, i kam përfunduar studimet themelore (AKM) dhe kam marrë titullin: *Bachelors in Programit Fillor*.

Duke i parë nevojat dhe kërkesat e vazhdueshme për ndryshimet rrënjosore në sistemin arsimor që po bëhen në gjatë këtyre viteve, vendosa që t'i regjistroj studimet master, në drejtimin *Udhëheqja në Arsim*, dhe pikërisht në vitin 2013, në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, para komisionit vlerësues, me tezën e masterit: *Zhvillimi i kapaciteteve të drejtoreve për udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollave*, kam marrë titullin *Master i Edukimit – Udhëheqje në Arsim (90 ects)*.

Zhvillimi profesionalë dhe dashuria për të nxënë gjatë gjithë jetës, janë hap i rëndësishëm dhe i pandalshëm për secilin mësimdhënës. Andaj që nga viti 2001 e deri më sot, kam ndjekur mbi katërqind e pesëdhjetë orë trajnime në programe të ndryshme.

Ndër to:

Fasilitues me bazë në shkollë për *Vlerësim formativ*, BEP - USAID, 2013.

Trajner për programin Parafillor-Fillor, “*Zbatimimi në praktikë i Kurikulës së re të Kosovës*”, MASHT, 2016.

Trajner për programin “*Qasja praktike për zbatimin e Kurikulës në klasat 0-5*”, European Union Kosovo-MASHT, 2019.

Trajner për programin “*Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin parauniversitar*”, SBASHK, 2020

Në vitin 2019, me pëlqimin e shumë mësimdhënësve dhe me fuqi të plotë vote, zgjidhem kryetar i SBASHK-ut për komunën e Malishevës.

#### Arsimimi sot:

Ju lutemi na flisni diçka për SBASHK-un në Malishevë?

#### Skënderi:

Të jesh kryetar i sindikatës së arsimit në nivelin komunal, ndoshta dikush mendon që është privilegji, por unë mendoj që është një detyrë me përgjegjësi të madhe ngaqë nuk është e lehtë që të punosh për plotësimin e kërkeseve të 850 sindikalisteve të arsimit sa disponon kjo komunë. Detyrën e kryetarit të SKAP-it, e ushtroj me plot vullnet. Që nga momenti kur jam zgjedhur në pozitën e kryetarit, me datën 29 prill 2019, kam bërë dhe jam duke bërë përpjekje maksimale, që këtë detyrëta kryej me nder, me përgjegjësi dhe transparencë të plotë. Në këtë rast, do ta kisha falenderuar për punën dhe angazhimin shumëvjeçar në SBASHK, paraardhësin timish-kryetarin z. Elez Krasniqin.



*Takim pune me kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave.*

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Sindikata Komunale e AMU-së dhe AML-së në Malishevë, përbëhet nga 39 shoqata sindikale: shoqata sindikale e çerdhes “Zërat e Ëmbël”, 35 Shoqata sindikale të ShFMU-së, shoqata sindikale e Gjimnazit “Hamdi Berisha”, shoqata sindikale e shkollës së mesme profesionale “Kujtim Krasniqi” në Malishevë dhe shkolla e mesme profesionale Ekonomiko-Juridike “Lasgush Porodeci” në Kijevë. Të gjitha strukturat udhëheqëse të SKAP-it, si dhe ato të shoqatave sindikale, kanë qenë dhe janë funksionale gjatë të gjitha proceseve dhe veprimeve sindikaliste që kanë ndodhur deri më tani. Edhe ne si Sindikatë Komunale e arsimit filllore dhe të mesëm, jemi të angazhuar për herë në përmbushjen e vizionit dhe misionit të SBASHK-ut për një arsim cilësor. Në këtë kontekst mund të themi se, të gjithë mësimdhënësve iu kemi ofruar mundësinë për të bërë ngritjen dhe zhvillimin profesional, përmes trajnimeve që i organizon SBASHK-u, me qëllim që këto trajnime të ndikojnë edhe në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësit e nxënësve. Përveç kësaj, çdo herë jemi të angazhuar në drejtim tëzbatimit të Kontratës Kolektive nga punëdhënësi i ynë. Gjithashtu, vlenë të theksojmë se, qëngë 13 mars i këtij viti e deri me sot në kohë pandemie të shkaktuar nga COVID-19, po thuaçse çdo ditë, shkëmbejmë informacione të ndryshme me të gjithë kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave. Këtë e realizojmë përmes aplikacionit në “vajber: (viber), që kemi formuar grupin përkomunikim të përbashkët, e shpeshherë sipas kërkesave dhe nevojave që kanë kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave, e realizojmë edhemë takime fizike me ta. Një gjë të tillë e praktikojmë edhe me strukturat udhëheqëse të SBASHK-ut, dhe me kryetarët e niveleve komunale të komunave të tjera. Kjo ndodhë më qëllim që të informohemi me kohë rrëthaktivitetave sindikale si dhe gjendjes së përgjithshme e shëndetësore të mësimdhënësve si dhe formave të punës që zhvillohen në secilën shkollë veç e veç sipas “Masterplanit” të hartuar nga MASHT-i.

## Arsimimi sot:

Sa i është dhënë hapësirë femrës në aktivitetet sindikale të SBASHK-ut?

## Skënderi:

Nëse kthehemë në kohën e para 20-25 viteve më parë, numrin e femrave të shkolluara në atë kohë mund ta numëronim në gishta, ndërsa sot, numri i femrave që punojnë në arsim, thuaçse është 50:50 në raport me meshkujt. Sipas statistikave që posedoja, para 3 muajsh, 97 % e gjinisë femërore është e anëtarësuar në sindikatë. Mirëpo, për t'u përgjigjur në pyetjen tuaj, se

sa i është dhënë hapësirë femrës në aktivitetet sindikale të SBASHK-ut, mund të them se, në të gjitha shoqatat sindikale të shkollave si dhe në nivel komunal, ju kemi ofruar mundësitetë dhe hapësirën e mjaftueshme në mënyrë që edhe femrat të janë pjesë estrukturave udhëheqëse të sindikatave. Nga numri i përgjithshëm i 39 shoqatave sindikale sa ka komuna e jonë, 5 prej tyre ose 13%, udhëhiqen nga femrat (pra, janë kryetare të shoqatave sindikale). Në kryesinë e SKAP-it e kemi pasur një femër, e cila ka qenë nën kryetare, por për arsyen personale është dorëhequr, ndërsa nga dy anëtarët e Këshillin Drejtues të SBASHK-ut nga Komuna e Malishevës njëri mashkull e tetra femër. Pasiqë në vitin e ardhshëm do të mbahen zgjedhjet në të gjitha nivelet e sindikatave, shpresoj dhe uroj se do të kemi edhe më shumë femra në strukturat udhëheqëse të sindikatave.

## Arsimimi sot:

Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK-ut?

## Skënderi:

Për të folur për të mirat e SBASHK-ut, sigurisht që na duhen orë të tëra. Të mirat e BAshK-ut, unë do t'i veçoja në dy rrafshe: në rrafshin organizativofunksional dhe në rrafshin e të mirave që anëtarësia e gjerë është përfituese e drejtpërdrejt. Në këtë kontekst do të bëjë përpjeke që t'i veçoj disa nga to:

### 1. Rrafshi organizativ dhe funksional:

Ka një kryetar, një kryesi dhe një staf administrativ shumë funksional dhe proaktiv në punën dhe angazhimet e tyre të përditshme.

SBASHK-u ka një shtrirje gjithëpërfshirëse në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe është unike i vetëm që t'i mbron interesat dhe të drejta e të punësuarve në të gjitha nivelet e arsimit, të kulturës dhe shkencës në përgjithësi.

SBASHK-u ka të zhvilluar një demokraci të brendshme ku çdoherë dëgjohet zëri dhe respektohet mendimi ndryshe i të gjithë akterëve që janë pjesë përbërëse e tij.

E mirë tjetër është se të gjitha vendimet që janë me rëndësi të veçantë, merren në mënyrë demokratike nga Këshilli Drejtues si organi më i lartë në mes të dy kongreseve.

### 2. Rrafshi i të mirave që anëtarësia e gjerë është përfituese:

Dyert eSBASHK-ut janë të hapura në çdo kohë për të gjithë anëtarësinë e sajqëkërkojnë këshilla dhe ndihmën juridike apo të natyrave të ndryshme.

Është Kontrata Kolektive e nënshkruar në mes të punëdhënësit dhe SBASHK-ut, në të cilën janë të



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

specifikuara të drejtat e punëmarrësve dhe detyrimet që kanë punëdhënësit në zbatimin e saj.

Organizimi i pushimeve verore për mësimdhënësit në bregdetin shqiptar në Durrës.

Organizimi dhe realizimi i trajnimeve të mësimdhënësve për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Këto ishin disa nga të mirat e përgjithshme të SBAShK-ut, mbështetur siç e thash më parë, për të veçuar të gjitha na duhen orë të tëra për t'i shkruar të gjitha.

## Arsimimi sot:

C'mendoni për trajnimet dhe angazhimet tuaja si trajner?

## Skënderi:

Ngritura e cilësisë në arsim është një proces dhe veprim që kërkon një angazhim të të gjithëve dhe duhet të jetë prioritet për të gjithë ata të cilët mund të kontribuojnë në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënësit e nxënësve. Pa dyshim se kjo mund të arrihet duke i mbështetur dhe duke i përkrahur mësimdhënësit në forma të ndryshme. E këtë, më së miri është duke e bërë SBAShK-u, pra, duke ju ofruar mbështetje të vazhdueshme të gjithë mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar për ngritjen dhe zhvillimin profesional të tyre.



Punë praktike me mësimdhënës gjatë realizimit të trajnimit.

Është për t'u vlerësuar lart puna e SBAShK-ut, sepse para disa vitesh ka filluar të realizojë trajnimin e mësimdhënësve. Gjithashtu vrerësoj trajnimet që vazhdojnë të realizohen edhe gjatë kohës së pandemisë, trajnime këto në distancë, me ç'rast SBAShK-u, ka angazhuar një numër të konsiderueshëm të trajnerëve në të gjitha programet. Tanimë lejoni t'i përvihendes dhe t'i përgëzoj për punën dhe angazhimin e tyre profesional të gjithë akterët që në çdo kohë u janë përgjigjur të gjitha kërkesave të mësimdhënësve të cilët kanë shprehur interesim të jashtëzakonshëm për t'i ndjekur këto 5 programet e trajnimeve të akredituara dhe të licencuara nga MASHT-i. Gjatë kësaj kohe, kam qenë pjesë e këtij grupi trajnerësh, me pajtimin e SBAShK-ut, sipas dispozitiveve ligjore, etike dhe profesionale -jam përzgjedhë trajner për programin: **"Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin parauniversitar"**.

Të jesh trajner i një ose disa programeve, mund të them së është një përgjegjësi e madhe. Nëse i referohemi thënies se: **"Mësimdhënia është art dhe shkencë"**, atëherë një trajner duhet t'i posedoj këto dy komponentë. Këtë më së miri e vlerësojnë të tjerët. Lidhur me këtë i falënderoj strukturat udhëheqëse të SBAShK-ut, të cilat më dhanë mundësinë që edhe unë të kontribuoj sado pak në ngritjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

## Arsimimi sot:

Do të shtonit diçka në fund të kësaj interviste?

## Skënderi:

Ishte kënaqësi e veçantë që t'u jap përgjigje pyetjeve tuaja. Meqë jemi në prag të festave të nëntorit (Festa e 28 Nëntorit - Dita e flamurit, ditëlindja e Komendantit Legjendar Adem Jashari dhe Dalja e parë në skenë e U? K-së, shpreh dëshirën që të ju uroj të gjithëve nga zemra muajin e festave të shqiptarëve! Urime dhe festofshim përherë të bashkuar! Ndërsa redaksisë suaj i dëshiroj punë të mbarë dhe suksese të pafundme në përbushjen e objektivave që i keni paraparë.

## Gjatë muajit

Delegacioni i SBASHK-ut u takua me Ministrin Likaj

### U debatua për aktualitetin në arsim dhe kërkesat e SBASHK-ut

Në fillim të muajit nëntor kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me ministrin Ramë Likaj dhe shefin e kabinetit të tij Gëzim Berisha. Në këtë takim të radhës është debatuar për aktualitetin në arsim dhe për kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut. U vlerësua lart angazhimi i përbashkët për rrjedhën e mbarë të procesit mësimor dhe realizmit të kërkesave të punëtorëve të arsimit. Ministri Likaj, me këtë rast është zotuar se do të angazhohet maksimalisht në realizmin e kërkesave të arsyeshme të mësimdhënësve, duke pasur parasysh situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe kushtet në të cilat po punojnë.



Ministri Likaj gjithashtu ka ritheksuar se duhet të punojmë të gjithë së bashku, në bashkëpunim edhe me

MSh-në dhe IKShPK-në që të mbrojmë shëndetin e nxënësve, mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjera në arsim dhe të mbajmë në jetë zbatimin e për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie, por duke vlerësuar se, asnje skenar tjetër nuk e zëvendëson pjesëmarrjen në shkollë.



Kryetari Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymeri janë shprehur se ndjehen krenar me gjithë angazhimin dhe përkushtimin me punëtorëve të arsimit, që nga çerdhet e deri në Universitete, në realizimin e misionit të tyre për arsimimin e edukimin e brezave. Ta kanë treguar edhe për kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut duke kërkuar që Ministri Likaj të vazhdojë të angazhohet në realizimin e tyre.

Edhe fundi i tatorit dhe fillimi i nëntorit shënojnë vazhdimin e trajnimeve

### Stafi qendror në krye të detyrës duke respektuar vullnetin e anëtarësisë



Gjatë gjithë këtij viti SBASHK ka shënuar rezultate të larta edhe në organizimin dhe mbajtjen me sukses të trajnimeve të licencuara duke respektuar kështu vullnetin e mijëra kolegëve tanë nga e tërë Kosova për

të qenë pjesë e këtij aktiviteti. Ky aktivitet është duke u mbajtur zakonisht ditëve të vikendit pasi që ditëve të punës kolegët tanë janë duke u angazhuar maksimalisht në rrjedhën e mbarë të procesit arsimor në këto kushte mjaf të vështirësuar nga Covid 19. Gjallëri e përkushtim është vërejtur edhe në vikendin e 31 tatorit kur tri grupe me kolegët tanë nga e tërë Kosova kishin nisur trajnimet "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajnerin Alban Zeneli, trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me traneren Pranvera Haziri dhe trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajneren Jehona Oruçin.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Kryetari i SBASHK-ut edhe kësaj radhe ëhtë kyçur duke bashkëbiseduar me trajnerët dhe pjesëmarrësите këtyre tri grupeve të trajnimit. Ai ka falënderuar trajnerët për përkushtimin dhe pastaj ka përgëzuar gjithë punëtorët e arsimit për angazhimet në misionin e tyre të shenjtë të edukimit e arsimit të brezave në këto kushte të vështirësuara shumë për shkak të gjendjes nga Covid 19.




Kryetari Jasharaj edhe gjatë kësaj bashkëbisede ka shprehur respekt për përkushtimin e koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, për stafin qendror, të cilët, krahas shumë detyrave ditore, po angazhohen maksimalisht edhe për organizimin dhe rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. Trajnerët e Zeneli, Haziri e Oruçi kanë vlerësuar se ky aktivitet ka përfunduar me sukses duke vlerësuar lart angazhimin dhe përkushtimin e pjesëmarrësve, të cilët përmes kryerjes së detyrave të shumta, që lidheshin me temat e shtjelluara, kanë dëshmuar për arritjen e njohurive të reja, njohuri këto që do t'i përdorin në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim.


Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror janë kyçur vazhdimisht në këto tri trajnime duke dhënë sqarime e duke u përgjigjur në pyetjet e shtruara nga pjesëmarrësit.

Atmosferë përkushtimi eshtë parë edhe në trajnimet e radhës. Shumë nga kolegët tanë bazuar në vullnetin e tyre kanë marrë pjesë në trajnimin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social"

me trajnerët Blender Shatri e Safet Beqiri, shumë të tjërë në trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" udhëhequr nga Jehona Oruçi e Hysen Sogjeva.



Kolegë të tjërë ishin në trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës shqipe dhe letërsisë në ciklin fillor e të mesëm" me trajneret Pranvera Haziri e Edona Mjekiqi, që është ndihmuar nga trajneri rof. Dr. Atdhe Hykollı. Atmosferë pune e përkushtimi eshtë vërejtur edhe në trajnimin "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajnerin Hysen Hyseni. Edhe me pjesëmarrësit në këto grupe trajnimesh ka bashkëbiseduar kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Pjesëmarrësit kanë shtruar edhe pyetje dhe kanë vlerësuar se ky aktivitet i SBASHK-ut eshtë i qëlluar dhe në shërbim të arritjes së njohurive të reja.



## SBASHK mbështet kandidatin nga Sllovenia për nënkyrjetar të ETUCE Respekt meritor për përkrahjen e vazhdueshme nga kolegët slloven

SBASHK-u falë angazhimit dhe përkushtimit të vazhdueshëm për të qenë në nivel të prezantimit e mbrojtjes së kërkeseve të anëtarësisë dhe sinqueritetit të bashkëpunimit me miqtë e shtetit tonë ka vazhduar të kultivojë marrëdhënie të shkëlqyera me shumë sindikata nga Ballkani, Evropa e tërë bota. Një bashkëpuni e miqësi e sinqertë eshtë krijuar tanë e sa dekada edhe me Sindikatën e Arsimit të Sllovenisë

(SVIZ). Sekretari i përgjithshëm i kësaj sindikate Branimir Shtrukel bashkë me shumë veprimtarë nga kjo sindikatë e një vendi mik për Kosovën vazhdimisht kanë qenë në mbështetje të SBASHK-ut. Ata në çdo aktivitet të tyrin kanë ftuar sindikatën tonë dhe kanë këmbyer përvojat me vlerë. Sekretari i përgjithshëm i SVIZ Branimir Shtrukel në kohët e kaluara eshtë angazhuar që SBASHK ta ketë vendin

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

meritor e të barabartë, siç e ka tani, mes sindikatave nga gjitha vendet e Evropës dhe botës.

Duke vlerësuar lart angazhimin e tij si zë i fuqishëm i sindikalizmit, jo vetëm në Slloveni e për arsimin slloven, SBASHK tregon edhe tani respektin meritor dhe mbështet fuqishëm kandidaturën e Shtrulej përenkryetar të ETUCE.


Në sindikaten SVIZ të Sllovenisë janë ndjerë të nderuar për këtë mbështetje dhe sekretari i përgjithshëm Shtrukel duke iu falënderuar SBASHK-ut në letrën e tij shprehet:

“Shumë i nderuari Rrahman, të gjithë kolegët tanë të nderuar nga Kosova!

Unë ju falënderoj shumë për shprehjet tuaja të mbështetjes për kandidaturën time, dhe ju siguroj që gjithmonë mund të mbështeteni tek unë dhe kolegët e mi sa herë që do të keni nevojë për ndonjë ndihmë, informacion ose mbështetje”.

SBASHK është i lumtur që Shtrukej u zgjodh nënkyetar në ETUCE në Konferencën virtuale të 1 e

2 dhjetorit për shkak të pandemisë dhe do të vazhdojë angazhimet e përkushtimin si zë i fuqishëm sindikal. Po ashtu me SVIZ do të vazhdojmë miqësinë e krijuar sinqerisht dhe moti duke bashkëpunuar e këmbyer ide në shërbim të forcimit të zërit sindikal në shërbim të anëtarësisë.



## Konferanca zgjedhore e Sindikatave të Arsimit të Evropës

### Kryetarja Blover në raportin e saj vend meritor i dha arsimit në Kosovë

Ishte planifikuar që Konferanca zgjedhore e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës të mbahej në Portugali më 1 e 2 dhjetor me pjesëmarrjen e delegatëve nga të gjitha sindikatat anëtare, por gjendja e rënduar nga Covid 19 ka bërë që kjo ngjarje e veçantë të organizohet përmes on line.

Në këtë Konferencë zgjedhore të ETUCE merr pjesë edhe SBASHK me 3 delegatë dhe 3 vëzhgues dhe me të drejtën për 21 vota sipas sistemit votues të këtij Komiteti Sindikal të Evropës, pasi është nga sindikatat me numër të madh anëtarësh.

Në hapje të punimeve të Konferencës kryetarja e ETUCE, Kristine Blover duke përshëndetur pjesëmarrësit ka shprehur respekt të lartë për të 11 milionë anëtarët kudo në Evropë për angazhimin përkushtimin e tyre përrjedhën e procesit mësimor në kushte tepër të vështirësuar nga Covid 19.



Kryetarja Blover duke bërë një analizë të situatës në arsimim kudo në Evropë ka treguar se në komunikim të vazhdueshëm edhe me SBASHK është vlerësuar se arsimi në Kosovë, si kudo në Evropë, po përballet me sfida dhe se punëtorët arsimor atje janë angazhuar përrjedhë sa më të mbarë të mësimit nga larg nga marsi e deri në përfundim të vitit të kaluar arsimor. Ajo ka shprehur keqardhje pse një numër nxënësish në Kosovë që janë nga familjet me kushte më të vështira ekonomike kanë pasur vështirësi për të qenë pjesë e mësimit nga larg. Kryetarja Blover duke u dhënë respekt meritor punëtorëve arsimor është shprehur se ne sot jemi duke organizuar konferencë me ane te teknologjisë, dhe kjo është e vërtetë, por në mësim teknologjia mund të ndihmojë mësimdhënësit por kurri nuk mund t'i zëvendësojë ata.



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pjesëmarrësit ka përvendetur pastaj drejtorja e përgjithshme e ETUCE, Suzan Flocken duke i informuar ata për mënyrën e votimit për kryetarin dhe nënkyetarët e pastaj është shprehur me respekt për angazhimin e punëtorëve arsimor nga e tërë Evropa, të cilët, si tha ajo, nuk u ndalen e nuk po ndalën së angazhuari që në gjithë mundësitë dhe format e mundshme të përcjellin dituritë te nxënësit e tyre.



Në vazhdim të punimeve të Konferencës delegatët e autorizuar kanë votuar duke zgjedhur kryetar të ri të ETUCE përfaqësuesin e sindikatës së mësimdhënësve të Skocisë, Llary Flanagan.

SBASHK i është gjuar zgjedhjes së kryetarit Flanagan dhe të nënkyetarëve Branimir Shtrukel nga

sindikata e arsimit të Sllovenisë (SVIZ) dhe znj. Trudi Kerpenen nga sindikata e arsimit ë Holandës (AoB) që janë miq të vjetër të SBASHK-ut dhe kanë mbështetur vazhdimisht me vite e dekada sindikatën e arsimit të Kosovës kudo në takimet ndërkombëtare sindikale.



Konferanca në ditën e dytë të punës do të debatojë pë raportin 5 vjeçar të angazhimeve e aktivitetave të ETUCE dhe sindikatave anëtare të saj dhe pastaj do të ketë edhe propozime konkrete e dokumente, që do të votohen për aktivitetin e këtij Komiteti për 5 vitet e ardhshme duke pasur parim kryesor, si gjithmonë, solidaritetin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë mes sindikatave nga të gjitha shtetet e Evropës e në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit sa më cilësor

## Pjesëmarje aktive në takimet për situatën në arsim **SBASHK me shembuj konkretet të përkushtimit të punëtorëve arsimor**

GIZ në bashkëpunim me MASH-in, SBASHK-un dhe partnerë të tjerë ka nisur tani e sa kohë fushatën e përbashkët për Arsim më të mirë në Kosovë. Krahas shumë aktivitetave të përbashkëta gjatë kësaj fushatë janë organizuar edhe 10 debate nga larg me pjesëmarrjen e këtyre partnerëve dhe të palëve të tjera të interesuara.



Kështu ishte edhe në debatin e 10 të radhës me temën "Cilat mundësi i ofron kriza aktuale e pandemisë sektorit të arsimit", që është mbajtur të enjten e 12 nëntorit. Në këtë debat ka marrë pjesë edhe Ministri i MASH-it Ramë Likaj, i cili ka treguar përgjendjen aktuale në arsim. Ai ka shprehur respekt për angazhimet e punëtorëve të arsimit dhe për sakrificën e tyre të vazhdueshme që edhe në këto kushte të

vështirësuara nga Covid-19 po kontribuojnë në rrjedhën e mbarë të procesit mësimor. Kontribut në rrjedhën e këtij debati ka dhënë edhe përgjegjësi i GIZ Boris, i cili ka bërë një shpalosje të aktivitetave në 3 vjetorin e fushatës për arsim më të mirë duke u ndalur në aktivitetet e shumat dhe në arritjet e përbashkëta.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut në të gjitha këto debate me shembuj konkret kanë treguar për përkushtimin dhe angazhimin e punëtorëve të arsimit në rrjedhën e mbarë të arsimit në institucionet arsimore. Kryetari i SBASHK-ut edhe kësaj radhe ka deklaruar se partitë politike dhe institucionet deklarimet se arsimin e kanë prioritet duhet ta kthejnë në vepër duke ndarë buxhet më të lartë për arsimin në mënyrë që të përmirësohen kushtet e punës në shkolla e institucione tjera arsimore dhe që shkumësi e shpuza të zëvendësohen me mjete bashkëkohore të punës arsimore.

